

VENDIM
Nr.683, datë 2.11.2005

PËR SHPALLJEN E KOMPLEKSIT LIGATINOR TË LIQENIT TË SHKODRËS E TË ZONËS SË LUMIT BUNA, ZONË NATYRORE VEÇANËRISHT E MBROJTUR, DHE PËRFSHIRJEN E TIJ NË LISTËN E LIGATINAVE ME RËNDËSI NDËRKOMBËTARE, VEÇANËRISHT, SI HABITATE TË SHPENDËVE UJORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 e 4 të konventës “Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë”, dhe të pikës 1 të nenit 13 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen zonë natyrore veçanërisht të mbrojtur dhe përfshirjen në listën e konventës “Ramsar”, “Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht, si habitate të shpendëve ujorë”, të territorit natyror të kompleksit ligatinor të liqenit të Shkodrës dhe zonës së lumit Buna (përfshi deltën dhe ishullin e Franc Jozefit, rezervatin e Velipojës, lagunën e Vilunit, plazhin e Baks-Rrjollit, kënetën e Domnit), si dhe territoret përreth tyre, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kufijtë e kësaj zone janë:

Nga veriu: Pika kufitare e Hanit të Hotit (42° 20'17" 19° 26');

Nga perëndimi: Kufiri shtetëror përgjatë lumit Buna me Republikën Serbi-Mali i Zi;

Nga lindja: Rruga automobilistike Shkodër-Hani i Hotit dhe vija që bashkon daljen e lumit Buna nga liqeni i Shkodrës deri te Rëra e Hedhur dhe që kalon nga zona malore (koordinatat: 41° 50'30" 19° 35'30", 42° 53'15" 19° 30', 41° 59'30" 19° 31'30", 42° 00', 19° 31'33", 42° 02'15" 19° 30', 42° 03'08" 19° 29');

Nga jugu: Vija që bashkon grykëderdhjen e liqenit të Shkodrës me pikën kufitare dhe vija bregdetare nga Rëra e Hedhur deri te grykëderdhja e lumit Buna (koordinatat: 41° 50'57" 19° 23', 41° 51'28" 19° 27'30", 41°50'58" 19° 30').

3. Zona ka një sipërfaqe prej 49 562 ha dhe ndahet në pesë kategori, sipas llojit të përdorimit të tokës, sipërfaqes së mbuluar me ujë dhe mbulesës bimore, që përcaktohet në:

a) Sipërfaqe ujore	15 719 ha;
b) Sipërfaqe lagunore	346 ha;
c) Duna ranore, bregdetare	496 ha;
ç) Sipërfaqe pyjore dhe shkurre	9764 ha;
d) Toka të kripura	252 ha;
dh) Sipërfaqe urbane, toka bujqësore, livadhe	22 985 ha.

4. Veprimtaritë ekonomike, që lejohen të ushtrohen në zonën “Ramsar” janë ato me karakter tradicional, që ruajnë vlerat mjedisore dhe që zhvillohen në përputhje me nivelin e mbrojtjes së zonës dhe me objektivat e planit të menaxhimit të saj.

5. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave që, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, me organizatat jofitimprurëse dhe me përfaqësues të komunitetit, të hartojë planin e menaxhimit të zonës.

6. Ngarkohen administratat e liqenit të Shkodrës dhe ajo e rezervatit të Velipojës, të realizojnë menaxhimin e zonës, në përputhje me planin e menaxhimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

